



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1236/2 prot.,

Datë 01.06.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “PIK” SHPK & “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-66335-04-18-2023, me objekt: “*Programi i nxitjes dhe rritjes së kapaciteteve të të rinjve në fushën e teknologjisë dhe inovacionit*” me fond limit 18.309.516,67 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
- Ankimues:** BOE “PIK” SHPK & “Optima Communication” SHPK
Rruga Pjeter Bogdani ,Nr.37,Kati 2, Tiranw
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

Në datën 31.05.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1236/2023 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3143 e BOE “PIK” SHPK & “Optima Communication” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-66335-04-18-2023, me objekt: “*Programi i nxitjes dhe rritjes së kapaciteteve të të rinjve në fushën e teknologjisë dhe inovacionit*” me fond limit 18.309.516,67 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “PIK” SHPK & “Optima Communication” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që BOE “PIK” SHPK & “Optima Communication” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1236 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

I. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.1 të Kapacitetit teknik pjesë e “Kritereve të vecanta të kualifikimit kërkon: “2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 7.323.806,66 (shtatë milion e treqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.” Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në s.p.e e konkretisht nga verifikimi i Kontratës së bashkëpunimit të përkohshme të BOE “PIK” sh.p.k dhe “OPTIMA COMMUNICATION” sh.p.k, rezulton se secili prej anëtarëve të BOE ka marrë përsipër të realizojë zërat: Nr. Shërbimi Përshkrimi i shërbimit Njësia Sasia Operatori përgjegjës 1 (FAZA II dhe FAZA III e ToRS) Fushata komunikimi brandimi dhe Organizimi i takimeve e trajnimeve 1.1 Mockup sipas termave të referencës shërbim 1 Optima Communication sh.p.k. 1.2 Spila copë 1000 Optima Communication sh.p.k. 1.3 Silolapsa copë 1000 Optima Communication sh.p.k. 1.4 Tote bags copë 1000 Optima Communication sh.p.k. 1.5 Blloqe copë 1000 Optima Communication sh.p.k. 1.6 Dosje të branduara copë 1000 Optima Communication sh.p.k. 1.7 Certifikata copë 1000 Optima Communication sh.p.k. 1.8 Banner i madh i printuar me përmasa 4 x 5 m me strukture copë 1 Optima Communication sh.p.k. 1.9 Rollup të printuara të përmasave 85x200 cm copë 4 Optima Communication sh.p.k. 1.10 Postera të branduara të përmasave A3 copë 15 Optima Communication sh.p.k. 1.11 Broshura të printuara të formatit A5 copë 1000 Optima

Communication sh.p.k. 1.12 Shërbime transporti shërbim 1 Pik sh.p.k. 1.13 Ndërfaqe Web shërbim 1 Pik sh.p.k. 1.14 Shërbime të tjera shërbim 1 Pik sh.p.k. 2 (FAZA IV dhe FAZA V e ToRS) Organizimi i mini-konkurseve në gjimnaze, Inkubimi dhe mentorimi i ideve 2.1 Katering banket për (70 x11) persona , përfshirë personel shërbyes shërbim 1 Pik sh.p.k. 2.2 Shërbim fotografie, fonie, projektor shërbim 1 Pik sh.p.k. 2.3 Shërbime të tjera shërbim 1 Pik sh.p.k. 3 (FAZA VI e ToRS) Konkursi Startup 3.1 Katering banket për 130 persona, përfshirë personel shërbimi shërbim 1 Pik sh.p.k. 3.2 Shërbim kafe për 130 persona, përfshirë personel shërbimi shërbim 1 Pik sh.p.k. 3.3 Shërbim fotografie dhe videomontimi , Foni, LED wall. shërbim 1 Pik sh.p.k. 3.4 Shërbime të tjera shërbim 1 Pik sh.p.k. 4 (FAZA VII e ToRS) Organizimi i festivalit përmyllës 4.1 Katering banket për 130 persona, përfshirë personel shërbyes shërbim 1 Pik sh.p.k. 4.2 Shërbim fotografie dhe videomontimi, foni, LED ëall shërbim 1. 4.3 Shërbime të tjera shërbim 1 Pik sh.p.k. 5 Tablet copë 35 Optima Communication sh.p.k. 6 Laptop copë 5 Optima Communication sh.p.k. Referuar sa më sipër, Operatori Ekonomik “PIK” sh.k.p ka marrë përsipër të realizojë zërat “Shërbime të tjera” 1.14, 2.3 dhe 4.3 të tabelës “Planifikimi i Buxhetit”, ku sipas termave të referencës pjesën kryesore të tyre e zë kryerja e shërbimeve: • Seanca trajnuese përpara realizimit të minikonkurseve. • Procese inkubimi/këshillimi/trajnimi i cili do të zhvillohet në bashkëpunim me mentorë dhe profesionistë të fushës së sipërmarrjes dhe TIK. • Aftësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të të rinjve. • Hartimi një studimi ku janë identifikuar dhe propozuar zgjidhje për problemet e hasura. Operatori Ekonomik “PIK” sh.k.p nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për të provuar përvojën e mëparshme (sipas kërkesave të kriterit 2.3.1 të dokumentave standarde të tenderit), të ngjashme me shërbimet e sipërcituara. të cilat janë thelbësore në realizimin e programit të nxitjes dhe rritjes së kapaciteteve..., duke sjellë kështu pasiguri dhe risks serioz për implementimin e një kontratë të sukseshme. Referuar sa më sipër, KVO gjykon se operatori ekonomik BOE “PIK” sh.p.k dhe “Optima Communication” sh.p.k nuk përmbush kërkesat e kriterit 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit (shtojca 8) e DST.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.06.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri